

Abstrakti

Trendet socio-ekonomike por edhe ata teknologjike gjithnjë e më tepër në botën bashkëkohore kanë ndikime shumëdimensionale dhe si pasojë e kësaj ato imponojnë edhe përshtatjen e mënyrës së marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi. Risitë në fushën e teknologjisë dhe dinamikat sociale kanë ndikuar edhe në presionin e administratave shtetërore që shërbimet e saj të jenë në harmoni me këto kërkesa. Minimizimi i kontaktit fizik me administratën shtetërore duhet të jetë prioritet i secilës administratë. Në këtë kuadër edhe ky punim është në funksion të pasqyrimit të kësaj logjike me fokus në fushën e burokracisë, përkatësisht të barrës administrative si njëra nga barrët me të cilën disavantazhet e saj si koha e ngarkesat e tjera për qytetarët, bizneset dhe investuesit e huaj janë pengesë e jetës dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Në këtë kontekst edhe përbajtja e këtij punimi është në funksion të pasqyrimit të asaj se sa shumë e rëndësishme është të bëhet lehtësimi i procedurave administrative në jetën praktike institucionale dhe vështirësitet me të cilën janë përballur administratat publike për kohë të gjatë. Gjithashtu punimi përmban edhe analiza dhe krahasime të atilla që të pasqyrojë gjendjen e procedurave administrative publike në të kaluarën dhe krahasimin me zhvillimin e teknologjisë që ka ndikuar në thjeshtësimin dhe lehtësimin e procedurave administrative. Përparësitet teknologjike imponojnë edhe strukturim të administratës publike, zvogëlimi i barrës administrative përcillet edhe me avantazhe dhe disavantazhe të saj në administratë, megjithatë përkundër konsekuencave, përparësitet dhe e vetmja mënyrë e rrugëtimit modern të administratës është reformimi i saj sipas risive teknologjike apo ajo që në gjuhën e qeverisjeve njihen si E-qeverisja.

Fjalët kyçë: *shtet, administratë, ekonomi, burokraci*